Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-6/26
24.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-6/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); neneve: 4 paragrafi 1.4, 13 paragrafi 1.4, dhe 14 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave; nenet: 13, paragrafi 1, dhe 73 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenin 9 të Rregullores Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.09.2026; me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0053079-4/26 dt. 15.09.2026); sjell këtë:

VENDIM
Për formimin e Jurisë Profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu"

1. FORMOHET Juria Profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu" në përbërje:
   1.1 Tafil Peci,
   1.2 Skender Muja, dhe
   1.3 Merita Maloku.
2. Juria Profesionale e formuar me pikën 1 të këtij vendimi shqyrton Propozimet inicuese për dhënien e çmimit "Kadri Kadriu" për vitin 2026, në bazë të Rregullores Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe anëtarët e Jurisë të emëruar me këtë vendim.
4. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:
1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të Jurisë